

UNMIK/RREG/2006/20
22 prill 2006

RREGULLORE NR. 2006/20

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2001/36
MBI SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Në përputhje me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 të datës 22 dhjetor 2001 mbi shërbimin civil të Kosovës,

Duke vepruar me kërkesë të Qeverisë,

Me qëllim të ndryshimit të neneve 6 dhe 22 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 në mënyrë që Qeverisë t'i mundësohet ushtrimi i përgjegjësi që kanë të bëjnë me shërbimin civil të Kosovës dhe për të shtuar angazhimin e mirëfilltë të Zyrës së Kryeministrit në funksionimin e Komisionit për Emërime të Larta Publike,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

Neni 1
Ndryshimet

Nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/36 ndryshohet si vijon:

- (a) Neni 6 ndryshohet si vijon:

Neni 6
Kodi i sjelljes

Nëpunësit civilë duhet t'i përmbahen kodit të sjelljes së shërbimit civil, që i është bashkëngjitur si shtojcë kësaj Rregulloreje apo ndonjë kodi tjetër të sjelljes së shërbimit civil që mund të miratohet më vonë me vendim të Qeverisë.

- (b) Neni 22 ndryshohet si vijon:

Neni 22
Shërbimet e sekretarisë, urdhëresat dhe udhëzimet

Zyra e Kryeministrit i ofron KELP-it shërbimet e sekretarisë dhe sipas nevojës i zbaton masat e tilla të nevojshme, duke e përfshirë nxjerrjen e urdhëresave dhe udhëzimeve për të lehtësuar funksionimin e KELP-së, si dhe të procedurave për emërimin, shkarkimin dhe vazhdimin e kontratave të të emëruarve në KELP. Urdhëresat e nxjerra në pajtim me këtë nen i nënshtrohen miratimit nga ana e Qeverisë.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 22 prill 2006.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm